



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primitje e Detyrës Punëve Prodato Received Delivery	20.04.2022	2	viti god year
Organ/Institucia Org./Unit	Nr. Prot. to Prot. Prot. No.	Titulli e Prot. e Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTICK	2273	2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.264 /2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani- kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca anëtarë, me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1758/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar e ankesën A.nr.361/2021, të datës 05.05.2021, të parashtruar nga ankuesja me adres

Projekt nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 20.04.2022, mori këtë;

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.361/2020 e datës 05.05.2021, e parashtruar nga ankuesja

II.Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 26.04.2021 me numër te port: 2021/ZDP/143 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, në pozitën "Zyrtar Certifikuese", me datën 05.05.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit: 2185/2021 e regjistruar me numër A.nr 361/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin për mos trajtim të barabartë në pagë, me koleget e sajë të punësuar në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, respektivisht ngritjen e gradës së pagës nga AAC5 në AAC5.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.05.2021 ka procedura kërkesën për përgjigjen në ankesë, ndërsa me datën 12.05.2021 Autoriteti i Aviacionit Civil ka përcjell përgjigjen në kërkesë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.11.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 16.03.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1758/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.07.2021 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 27.09.2019.

Ankuesja me datë 04.06.2021 dhe datë 05.04.2022 ka parashtruar shkresa në Këshillë përmes të cilave ka plotësuar ankesën e saj fillestare, ndërsa Këshilli me datë 19.04.2021 i është drejtuar me kërkesë për prova shtesë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, ndërsa Menaxherja e Personelit me datë 19.04.2021 ka dërguar sqarimet me provat e nevojshme

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit merititor ka administruar këto prova: Ankesën e datës 05.05.2021 të regjistruar me numër të protokollit:2185/2021 te parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës të datës 04.06.2021 me numër te protokollit 2874/2021; Njoftimin e datës 26.04.2021 me numër 2021/ZDP/143 e Drejtorit te Përgjithshëm ne Autoritetin e Aviacionit Civil; Kërkesën e ankueses të datës 13.04.2021 me numër 2021/ZDP/124 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil; Kërkesën e datës 11.05.2021 me numër të protokollit 2299/2021; Përgjigjen e datës 12.05.2021 me numër të protokollit 2361/2021; Akte Emërimit e datës 01.05.2020 si dhe përshkrimi i detyrave të punës; Emilin e datës 26.04.2021 dërguar nga ankuesja për me korrespondencën e bashkangjitur me përbërje prej 3 faqesh; Njoftimin e Këshillit të datës 06.07.2021; Fletëkthesën e datës 13.07.2021; Aktgjykim A.nr.1758/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Plotësimin e ankesës të datës 05.04.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa bazuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 01.05.2020, është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Zyrtar Certifikues" me gradë AAC-5 në Autoritetin e Aviacionit Civil, ndërsa e njëjta me datë 13.04.2021 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i



Përgjithshëm me qëllim të ngritjes së gradës respektivisht koeficientit të pagës me pretendimin se pozita që e ushtron "Zyrtar Certifikues", për nga pesha dhe përgjegjësia është ekuivalente me nivelin apo gradën AAC-3, kurse Drejtori i Përgjithshëm me datë 26.04.2021 e ka njoftuar stafin si dhe ankuesen nëpërmes e-mailit se, citoj: "Ju njoftoj se bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe udhëzimeve që kemi pranuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, asnjë procedurë rekrutimi, lëvizje brenda kategorisë dhe ngritje në detyrë nuk mund të fillohet nëse pozita e cila plotësohet paraprakisht nuk është paraparë në organizimin e brendshëm të institucionit dhe nuk është siguruar buxhet për atë pozitë. Në bazë të Ligjit Nr.07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 në kategorinë e pagave dhe shtesave në ACC-në, mbulon pozitat aktuale. Me këtë ndarje të buxhetit nuk është parapare ndonjë rritje e pagave apo avancim në pozita..."

Kolegji me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe bazës juridike pas pranimit të plotësimit të ankesës së ankueses të datës 05.04.2022 i është drejtuar me kërkesë për prova shtesë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me datë 19.04.2021 me specifikacionin: "Ju lutem a mund të na njoftoni se pozita "Zyrtar i Lartë" me cilën kategori është ekuivalente në kuptim të pagës në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, duke iu referuar gradave nga AAC-5 deri tek AAC-1", ndërsa Menaxherja e Personelit me datë 19.04.2021 ka kthyer përgjigje nëpërmjet e-mailit zyrtar me sqarimet e dhëna si vijon: "Referuar emailit tuaj si me poshte shenuar ju informoj si ne vijim: Grada: AAC-1 Drejtori Përgjithshëm; Grada: AAC-1.1 Zvendës/Drejtori i përgjithshëm; Grada: AAC-2 Fix - 2375.00 Hynë: Drejtorat e departamenteve të AAC-së përjashtimisht e drejtorit të administratës që ka gradën : DAAC Drejtor i administratës (AAC) 1250.00; Grada : AAC-3 Fix - 1937.50 Hynë: Inspektorat e AAC-se sipas departamenteve dhe Zyrtar/e lartë për bashkëpunim ndërkombëtar dhe Këshilltar/e për çështje ligjore; Grada : AAC-4 Fix - 1625.00 Hynë: Zyrtar për rregullim ekonomik, Zyrtar për shërbime të navigacionit ajror dhe Zyrtare e aviacionit të përgjithshëm dhe Zyrtar i vlefshmerise ajrore e kanë gradën AAC-4; Grada: AAC-5 Fix - 875.00 Hynë: Zyrtari Kryesor Financiar, Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore, Udhëheqësi i Prokurimit, Zyrtarja Certifikuese, Zyrtari për Shpenzime dhe Administratë, Zyrtarja Ekzekutive; Grada: ADAC Asistent (AAC) 750.00 Asistenti i Logjistikës-Zyrtar i pranimit të mallit/logjistikë; Të bashkëlidhura i gjeni shkresat e MAP ku janë të specifikuara gradat, por ndryshimi ka ndodh sipas rritjes së Vendimit të Kryeministrit me Nr. 01/176, datë 10.03.2014 ku për secilën grade ka një ndryshim në 25 % përdallim nga shkresat e bashkëlidhura" përgjigje kjo të cilën e ka mbështetur me shkresën e bashkangjitur të lëshuar nga DASHC/Ministria e Administratës Publike lidhur me procedimin e sistemit të pagave për Autoritetin e Aviacionit Civil të datës 31.05.2010 si dhe në shkresën e datës 04.04.2009 të lëshuar nga DASHC/Ministria e Administratës Publike lidhur me procedimin e sistemit të pagave për Autoritetin e Aviacionit Civil, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se kërkesa e ankueses drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës si dhe pretendimeve ankimore të parashtruara në Këshill ka të bëjë më ngritje në karrierë për dy (2) grada nga ajo AAC-5 në AAC-3 e cila sipas sqarimeve dhe shpejtimeve të dhëna është gradë e përcaktuar për tjera pozita dhe kategori funksionale.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil neni 7 ku përcaktohet se: "Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike ia propozojnë gradat e pozitive në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria, me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për



financat”, andaj mbi këtë bazë si dhe *konstatimeve të dhëna si më lartë në këtë vendim*, Kolegji ka konstatuar që avancimi në vendim e punës duhet të bëhet përmes zhvillimit të procedurave të rekrutimit, ndërsa pretendimet e ankueses janë të pabazuara ngase kërkesa e saj për ngritje të gradës nga AAC-5 në AAC-3 realisht është avancim dhe nuk mund të bëhet duke anashkaluar procedurat e përcaktuara si më lartë.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se : *1.E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil* si dhe nenin 9 paragrafi 1 ku është përcaktuar së *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës”* dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se drejta në pagë është e drejtë themelore e nëpunësit civil nga marrëdhënia e punës dhe se nëpunësi civil ka të drejtën e realizimit të pagës bazë të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës, andaj në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në provat e lëndës Kolegji konstaton se ankuesja në Akt Emërtim e saj të datës 01.05.2020 ka të përcaktuar kategorinë funksionale -Grada AAC-5 të pagës dhe së e njëjta po ashtu realizon pagën të përcaktuar sipas kategorisë funksionale-Grada AAC-5 në kuadër të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.264/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

